

Abstrakt

Krizat financiare globale janë ndër problemet më të mëdha të cilat e sfidojnë njerëzimin duke pasur ndikim të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë në ekonominë e të gjitha vendeve. Krizat financiare paraqiten vazhdimisht për arsye të ndryshme, qofshin ato për arsye natyrore apo për shkak të problemeve që shkaktohen nga politikat e gabuara monetare ose ekonomike, nga luftërat apo nga problemet në një sektor të caktuar ekonomik.

Me trendet e fundit të globalizimit që ekonomia çdo ditë po zhvillohet mes shteteve me njëra tjetrën, përveç benefiteve që po krijon në zhvillim shumë të shpejtë të të gjitha shteteve, kjo njekohësisht do të bëjë që në rast të një krize në një shtet, të afektojë të gjitha shtetet që kanë tregti direkte apo indirekte me atë shtet ku si shembulli më i mirë për ta ilustruar këtë është kriza e vitit 2008, ku falimentimi i bankës “Lehman Brothers” në Shtetet e Bashkuara të Amerikës afektoi ekonomiksht pothuajse gjysmën e shteteve të botës në mënyrë direkte dhe pothuajse të gjithë botën në mënyrë indirekte. Në kohë krizash financiare rolin kryesor për zvogëlimin e efekteve dhe kapërcimin e krizave e kanë bankat qendrore të shteteve përmes politikave monetare që ato udhëheqin. Në këtë rast në Shtetet e Bashkuara të Amerikës këtë rol e ushtron Rezerva Federale (FED) e cila udhëheq politikat monetare të Dollarit Amerikan (USD) i cili përveç në SHBA përdoret edhe në nëntë territore të varura dhe tetë shtete të pavarura. Roli i USD është shumë i madh edhe në shtetet e tjera sepse është valuta më e përdorur si rezervë valutore dhe është gjerësisht e përdorur në ekonominë ndërkombëtare.

Ndërsa në Zonën Euro apo siç njihet Eurozona këtë rol e ushtron Banka Qendrore Evropiane e cila udhëheq politikat monetare me valutën Euro e cila përdoret në njëzet e pesë shtete e në mesin e tyre edhe Republika e Kosovës e cila në mënyrë unilaterale së bashku me Malin e Zi e kanë bërë valutë të tyre pa marrëveshje paraprake me Bankën Qendrore Evropiane. Përveç përdorimit direkt gjithashtu Euro përdoret gjerësisht në tregtinë ndërkombëtare dhe si valutë rezervë e shumë valutave. Për shkak se këto dy institucione udhëheqin dy valutat më të mëdha në botë, roli i tyre është shumë i madh në ekonominë globale. Mekanizmat dhe detyrat të cilat i kanë i bëjnë të kenë rol vendimtar si në zhvillimin ekonomik gjithashtu edhe në kohën e krizave financiare globale. Këto dy institucione ushtrojnë ndikimin e tyre përmes mekanizmave si vendosja e normave të interesit dhe caktimin e rezervave të cilat janë mekanizmat më të rëndësishme në kohën e krizave financiare. Mënyra se si udhëheqin me këto politika këto banka është determinuese për zvogëlimin e pasojave të krizave por edhe për rikuperimin sa më të shpejtë të ekonomisë. Gjithashtu ne kemi valutë zyrtare euron që bënë që politikat monetare të Bankës Qendrore Evropiane të kenë impakt direkt edhe në ekonominë tonë. Në të ardhmen vendi jonë do të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian dhe do të duhet të aplikojë si shtet anëtarë i Eurozonës, që do të thotë se jo vetëm që do të kenë ndikim më të madh politikat monetare të Bankës Qendrore Evropiane, por ne do të kemi pjesëmarrje dhe vendimarrje direkte në hartimin e këtyre politikave përmes anëtarëve në të gjitha mekanizmat e kësaj banke.

Kandidati: Nderim Neziri

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Mejdi Bektashi